Kantoni i Zyrihut
Drejtoria e Shëndetit
Zyra Veterinare

# Doreshkrim

Për mbajtësit dhe mos-mbajtësit e qenve



Udhëzimet dhe rregullat e paraqitura me «Dorëshkrimin mbi qentë» të Zyrihut kanë si objektiv bashkëjetesën pa konflikte dhe jo të ndërlikuar të qenve, mbajtësve të tyre dhe njerëzve, me të cilat ju përballeni çdo ditë në jetën e përditshme. Rregullat i referohen situatave, në të cilat realizohen përballje të tilla dhe në të cilat kemi të bëjmë mbi të gjitha me tolerancë reciproke, respekt dhe gatishmëri për të komunikuar. Mos mbajtësit e qenve, të cilët dinë, se si duhet të sillen kundrejt qenve, dhe mbajtës të qenve, të cilët marrin përsipër përgjegjësinë dhe detyrimin e tyre të përkujdesjes, ndihmojnë për të mënjanuar konflikte dhe aksidente. Në këtë mënyrë ato kontribuojnë, që bashkëjetesa e njerëzve dhe e qenve të mos ketë nevojë të rregullohet me rregullore të tjera.

Në përputhje me këtë gjë orientohen edhe këshillat dhe informacionet në «Dorëshkrimin e qenve» jo vetëm për mbajtësit e qenve, por edhe për mos mbajtësit e qenve. Ne të gjithë mundësojmë me një sjellje të ekuilibruar dhe me pak vëmendje, një qëndrim me njëri-tjetrin dhe pranë njëri-tjetrit të relaksuar të qenit dhe njeriut në hapësirën e lejuar publike. Dhe së fundmi ne ja bëjmë më të lehtë qenve, të lëvizin të përshtatur dhe në përputhje me llojin e tyre në shoqëri.

Zyra Veterinare e Kantonit të Zyrihut



# Rregullat bazë

Në rast vëmendje të pasigurt
në rastin e sjelljes së gjuetisë
në rastin e sjelljes së padëshirueshme të ruajtjes
kur kemi të bëjmë me instinkt të tepruar të mbrojtjes
në rast sëmundjesh ngjitëse
gjatë kohës së ndërzimit
në zona natyrore të mbrojtura
në rezervate për ruajtjen e kafshëve të egra

**qeni normalisht nxirret i lidhur në rrip.**

Në rastin e një terreni të hapur ai mund të nxirret edhe me një rrip të gjatë.



**a**



Në qarkullim publik
në stacione trenash
në stacione autobusi
në rrugë me shumë trafik
nëse dikush ju lutet
në restorant dhe në ndërtesa të tjera publike
gjatë përballjeve me qenë të tjerë të lidhur

**qeni nxirret me një rrip të shkurtër.**



**b**

Në lagjet e banimit
në afërsi të kopshteve dhe shkollave
në afërsi të shesheve të lodrave dhe sporteve
në terrene të ç‘rregullt
në errësirë

**qeni nxirren me rrip të shkurtër ose në rast se bindet nxirret i kontrolluar në afërsi direkte.**



**c**



Në varreza
në pishina
në vendpushime shkollash
në fusha lojërash dhe sporti
në organizime të mëdha si koncerte, festa fshati,
organizime sportive ose në pazar

**qeni nuk merret me vete.**



**d**



# Dorëshkrimi për mbajtësit e qenve

**01**

**Kush nxjerr një qen, mund ta kontrollojë atë në çdo situatë dhe ta ndalojë atë në përputhje me forcën.**



**02**

**Gjatë përballjes me kalimtarët ose mbajtës të tjerë të qenve me qentë e tyre, qeni kalohet gjithmonë në anën tjetër dhe me rrip të shkurtër.**

Në rast bindje të sigurt ai mund të drejtohet afër vetes.



**03**



## Nëse kemi ndonjëherë konflikte, atëherë ruhet një sjellje xhentile.

Nëse dëshironi mund të jepni të dhëna mbi personin Tuaj (mbiemri, adresa, numri i telefonit).

**04**



## Qeni nuk urinon në vendet e papërshtatshme. Jashtëqitja e tij në çdo situatë hiqet në mënyrën më korrekte të mundshme dhe pa lënë gjurmë.

**Në restorant qeni i lidhur vendoset në atë mënyrë, që ai të mos pengojë klientët dhe personelin e shërbimit dhe që askush të mos ta shkelë atë.**

Përveç të tjerave kihet kujdes që askush të mos shqetësohet nga aroma dhe lehja e qenit.



**05**

**Gjatë ecjes së lirë qeni gjendet vazhdimisht në distancë shikimi dhe thirrje.**



**06**


Gjatë kohës së vegjetimit qeni normalisht nuk qëndron në barë të lartë dhe në arë.
Sendet e përdorura gjatë lojës nuk lihen asnjëherë në lëndinë.
07


Në rast nxjerrje të disa qenve është garantuar, që ato të mund të kontrollohen në tufë.
Kryesisht të gjithë qentë duhen nxjerrë të lidhur me rrip.
08

**Nëse ka prezent fëmijë, atëherë si fëmijët ashtu edhe qeni mbahen në çdo kohë nën vëzhgim.**

Qeni gjendet në çdo situatë nën kontroll.



**09**

**Nëse nxirren qentë nga fëmijë dhe adoleshentë, ato në çdo moment kohor mund të ndalohen dhe kontrollohen.**



**10**


Dorëshkrim
për mos mbajtësit
e qenve



**Një qen kalohet gjithmonë në një distancë të madhe dhe me një mënyrë të qetë të ecuri.**



# 01



**Shikimi në sytë e një qeni është tabu. Ndërsa vëzhgimi i tij në këndin e syrit është një detyrim.**

Nëse qeni nga prezenca e një personi të caktuar tregon frikë, shqetësim ose agresion (hungërimë, lehje, tregim të dhëmbëve), atëherë është e rëndësishme, të injoroni qenin dhe të zmadhoni me ngadalë distancën me të.



# 02

## Qentë lejohen të përkëdhelen ose ushqehen vetëm pas lejes së qartë të mbajtësit të qenit.

Urdhrat në këtë rast duhen respektuar plotësisht.



03

## Nëse kemi ndonjëherë konflikte, atëherë ruhet një sjellje xhentile.

Nëse dëshironi mund të jepni të dhëna mbi personin Tuaj (mbiemri, adresa, numri i telefonit).



04

**Vrapuesit, ato që udhëtojnë me biçikletë, ato që udhëtojnë me patina etj., të cilët i afrohen një qeni nga mbrapa, duhet të bëhen shpejtë të dallueshëm, në mënyrë që mbajtësit të qenit ti mbetet kohë e mjaftueshme, për të kontrolluar qenin e tij.**

Pastaj qeni kalohet në një distancë të madhe me shpejtësi hapi.



**05**



**Janë prezent fëmijë dhe qen në të njëjtin vend, ato qëndrojnë gjatë gjithë kohës të vëzhguar.**



**06**

Botuesi
Zyra Veterinare e Kantonit të Zyrihut

Përgatiti
feurer network ag, Zyrih

Vizatoi
Claude Huber dhe Pascale Osterwalder

Druckerei Feldegg AG, Schwerzenbach
Shtypur në FM-Staccatoraster.
Prodhuar në procese të qëndrueshme
(Sistemi i menaxhimit të ambientit ISO 14001).
Prodhuar klima-neutral.

E Nëntorit 2011
Perkthimi, Shtator 2012